



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 393/1 prot.

Tiranë, më 19.6.2024

**VENDIM**  
**Nr. 39, datë 19.6.2024**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË**  
**VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 77, DATË 27.9.2023**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, i ndryshuar, miratuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Zbatimin e Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 77, datë 27.9.2023, të Komisionerit, “Për rregullimin e paligjshmërisë që është konstatuar nga Komisioneri, gjatë verifikimit të procesit të vlerësimit periodik të punës, që është realizuar nga zyrtarët vlerësues, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe në Ministrinë e Brendshme, për periudhën Janar - Qershor 2023”.

**KONSTATOVA SE:**

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është rregjistruar kërkesa me nr.814 prot., datë 25.7.2023, e paraqitur nga nëpunësi \*\*\*\*\*, përmes të cilës ka ngritur disa pretendime për parregullsi, të lejuara gjatë realizimit të procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Janar - Qershor 2023.

Për verifikimin e informacionit, bazuar në nenin 16, Kreu III “Procedura paraprake”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, i ndryshuar, miratuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është kryer hetimi administrativ i këtij rasti. Për këtë qëllim, Komisioneri ka kërkuar nga institucioni, Ministria e Brendshme, të gjithë materialin shkresor që provon veprimet administrative të kryera për këtë rast.

Në përfundim të këtij hetimi administrativ procesi është përmbyllur me vendimin nr. 77, datë 27.9.2023, të Komisionerit, *“Për rregullimin e paligjshmërisë që është konstatuar nga Komisioneri, gjatë verifikimit të procesit të vlerësimit periodik të punës, që është realizuar nga zyrtarët vlerësues, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe në Ministrinë e Brendshme, për periudhën Janar - Qershor 2023”*.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Ministria e Brendshme, me shkresën nr. 862/11 prot., datë 3.11.2023, *“Mbi zbatimin e vendimit të Komisionerit”*, ka vënë në dispozicion të këtij të fundit dokumentacionin që materializon veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 77, datë 27.9.2023, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, materializuar në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin objekt i këtij verifikimi, paraqitet si më poshtë vijon:

Për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, ***në pikën 1 dhe 2***, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile, në cilësinë e *Zyrtarit Raportues*, dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme, në cilësinë e *Zyrtarit Kundërfirmues/Autorizues* të vendosë respektivisht anulimin e procesit dhe aktit të vlerësimit të rezultateve në punë, si dhe procesit të rivlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Janar - Qershor 2023, për nëpunësin civil *\*\*\*\*\**, si procese të kundraligjshme.

Në lidhje sa më sipër, rezulton se, me shkresën nr. 862/11 prot., datë 3.11.2023, *“Mbi zbatimin e vendimit të Komisionerit”*, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme ka njoftuar se në datën 31.10.2023, zyrtari autorizues ka zhvilluar një takim me nëpunësin, dhe ka kryer rivlerësimin e rezultateve në punë për periudhën Janar - Qershor 2023, duke e rivlerësuar me 2 (*Mirë*).

Për këtë proces është mbajtur Procesverbali i regjistruar me nr. 8102/9 prot., datë 31.10.2023, nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në takim (*Sekretari i Përgjithshëm, Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Përgjegjësia e Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe nëpunësi \*\*\*\*\**).

Me shkresën nr. 8102/10, datë 31.10.2023, njësia e burimeve njerëzore, i ka përcjellë nëpunësit *\*\*\*\*\**, rivlerësimin e kryer nga zyrtari autorizues. Ky i fundit me datën 2.11.2023, ka përcjellë formularin e vlerësimit ku ka shprehur dakordësinë e tij në lidhje me rivlerësimin e bërë.

Për sa u parashtrua më sipër, konstatohet se nga ana e institucionit objekt i mbikëqyrjes në vazhdim, Ministria e Brendshme, janë zbatuar detyrat e lëna në vendimin paralajmërues të Komisionerit.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, i ndryshuar, miratuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 77, datë 27.9.2023, të Komisionerit, “Për rregullimin e paligjshmërisë që është konstatuar nga Komisioneri, gjatë verifikimit të procesit të vlerësimit periodik të punës, që është realizuar nga zyrtarët vlerësues, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe në Ministrinë e Brendshme, për periudhën Janar - Qershor 2023”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile duke zbatuar detyrat e lëna në dispozitivin e Vendimit nr. 77, datë 27.9.2023.
3. Për këtë vendim të njoftohet Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile si dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**